



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBETARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Gjeografi e thelluar

Varianti A

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	C	D	C	A	D	B	A	C	D	C

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 11

Model përgjigjeje

Hartë topografike

Lumi rrjedh në drejtim të VL sepse lumenjtë zakonisht derdhen në: lumenj të tjerë; në liqene; në dete ose në oqeanë. Në rastin konkret lumi derdhet në drejtim të oqeanit.

OSE

Lumi rrjedh nga vendet me lartësi më të madhe drejt vendeve me lartësi më të ulët (bazuar në vlerat e izohipseve).

3 pikë Nëse përcakton llojin e hartës, drejtimin në të cilin rrjedh lumi dhe shpjegimin pse rrjedh në atë drejtim.

OSE

2 pikë Nëse përcakton llojin e hartës dhe drejtimin në të cilin rrjedh lumi **OSE** drejtimin në të cilin rrjedh lumi dhe shpjegimin pse rrjedh në atë drejtim.

1 pikë Nëse përcakton llojin e hartës **OSE** drejtimin në të cilin rrjedh lumi

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 12**Model përgjigjeje**

Lokacioni relativ jep vendodhjen e një vendi në raport me vende të tjerë, ndërsa lokacioni absolut jep vendndodhjen e saktë të një vendi nëpërmjet koordinatave gjeografike.

- Shqipëria gjendet në Evropën Juglindore
- Shqipëria gjendet perëndim të gadishullit të Ballkanit.
- Shqipëria kufizohet me Greqinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Kosovën.
- Shqipëria gjendet në Hemisferën Veriore
- Shqipëria laget nga detet Adriatik e Jon etj.

3 pikë Nëse shkruan ndryshimin midis lokacionit relativ dhe atij absolut dhe përshkruan lokacionin relative të Shqipërisë me dy fjali.

OSE

2 pikë Nëse shkruan ndryshimin midis lokacionit relativ dhe atij absolut dhe përshkruan lokacionin relativ të Shqipërisë me një fjali **OSE** përshkruan lokacionin relativ të Shqipërisë me dy fjali.

1 pikë Nëse shkruan ndryshimin midis lokacionit relativ dhe atij absolut **OSE** përshkruan lokacionin relativ të Shqipërisë me një fjali.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 13**Model përgjigjeje**

Relievat e ndërtuara nga shkëmbinjtë metamorfikë dallohen për maja të larta e të mprehta në mermerë dhe relievet të butë kur përbëhen nga reshpet argjilore.

Relievat e ndërtuara nga shkëmbinjtë gëlqerorë në përgjithësi janë të ashpra, me kreshta dhe shpate të thepisura. Në to veprojnë proceset e karstit me forma të shumta karstike sipërfaqësore e nëntokësore.

Në relievet e ndërtuara nga shkëmbinjtë terrigjenë zhvillohet erozion i fuqishëm. Për këtë arsye relievi është i butë me pjerrësi të vogël të shpateve dhe tepër i copëtuar.

3 pikë Nëse evidenton karakteristikat e relievit në të tre tipet e shkëmbinjve

OSE

2 pikë Nëse evidenton karakteristikat e relievit në dy nga tipet e shkëmbinjve

1 pikë Nëse evidenton karakteristikat e relievit në një nga tipet e shkëmbinjve

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 14

- a) Ekonomi e centralizuar
- b) Mohimi i pronës private
- c) Zëvendësimi i saj me pronën shtetërore
- d) Izolimi total i vendit nga e gjithë bota etj.

3 pikë Nëse rendit tre nga karakteristikat e ekonomisë në vitet 1945-1990.

OSE

2 pikë Nëse rendit dy nga karakteristikat e ekonomisë në vitet 1945-1990.

1 pikë Nëse rendit një nga karakteristikat e ekonomisë në vitet 1945-1990.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

Tjetërsimi fizik për shkak të ngricave ndodh kur temperaturat janë rreth 0°C , kur shkëmbinjtë janë të çarë e të plasaritur dhe kur këto të çara e të plasaritura mbushen me ujë. Kur temperatura ulet nën 0°C , uji në të çarat e shkëmbit ngrin. Akulli i formuar duke rritur volumin ushtron trysni mbi shkëmbin dhe ky i fundit thërrmohet.

Ky lloj tjetërsimi është i fuqishëm në zona të ftohta.

3 pikë Nëse shpjegon saktë pse ndodh tjetërsimi fizik për shkak të ngricave dhe shkruan se në cilat kushte mbizotëron ai.

OSE

2 pikë Nëse bën shpjegimin e saktë të kërkesës së parë **OSE** bën shpjegim të pjesshëm të kërkesës së parë dhe bën saktë kërkesën e dytë.

1 pikë Nëse bën shpjegim të pjesshëm të kërkesës së parë **OSE** bën saktë kërkesën e dytë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16**Model përgjigjeje**

Rritje e remitançave (të ardhurave që sjellin emigrantët)

Mësimi i profesioneve të reja dhe zbatimi i tyre në sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit.

Rritja e nivelit arsimor e kulturor të fëmijëve të emigrantëve.

Ulje e papunësisë në vend.

Njohja me kulturat e tjera etj.

3 pikë Nëse rendit tre nga efektet pozitive

OSE

2 pikë Nëse rendit dy nga efektet pozitive

1 pikë Nëse rendit një nga efektet pozitive

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 17**Model përgjigjeje**

Klimë më të ngrohtë ka qyteti i Londrës.

Rrymat e ngrohta oqeanike ndikojnë në zbutjen e klimës në Londër, pasi:

- Londra gjendet pranë oqeanit

- Rrymat e ngrohta ndikojnë më shumë në zbutjen e klimës krahasuar me Irkutsk që gjendet më në brendësi të kontinentit krahasuar me Londrën.

3 pikë Nëse gjen se cili nga qytetet ka klimë më të ngrohtë dhe jep dy argumente për këtë.

OSE

2 pikë Nëse gjen se cili nga qytetet ka klimë më të ngrohtë dhe jep një argument për këtë.

1 pikë Nëse nëse gjen se cili nga qytetet ka klimë më të ngrohtë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18**Model përgjigjeje**

- Pozita e favorshme gjeografike, duke zënë gjithë pjesën perëndimore më fushore të vendit, që është e favorshme për zhvillimin e degëve të ekonomisë.
- Dalja e gjerë në detin Adriatik, e cila favorizon zhvillimin e turizmi, tregtisë, peshkimit etj. Këtu gjenden portet më të rëndësishme të vendit.
- Mbizotërimi i relievit fushor, tokave pjellore, klimës tipike mesdhetare, pasurive të mëdha ujore, të cilat favorizojnë zhvillimin e bujqësisë, etj
- Rezervat e lëndëve djegëse të cilat favorizojnë zhvillimin e industrisë
- Përqendrimi në këtë rajon i potencialit human (numri i madh i popullsisë), qendrave më të mëdha urbane, ekonomike, që favorizojnë punësimin dhe zhvillimin.
- Mundësitë e komunikimit të këtij rajoni me gjithë rajonet e tjera të vendit etj.

3 pikë Nëse shpjegon tre nga faktorët

OSE

2 pikë Nëse shpjegon dy nga faktorët

1 pikë Nëse shpjegon një nga faktorët

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 19**Model përgjigjeje**

- Përmbytja e zonave të ulëta pranëbregdetare.
- Ndryshimi i konfiguracionit të vijës bregdetare.
- Rritja e sipërfaqes së oqeaneve dhe zvogëlimi i sipërfaqeve tokësore.
- Ndryshimet klimatike etj.
- Dëmtimi i ekosistemeve detare, bregdetare, tokësore.

3 pikë Nëse shkruan tre nga pasojat

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy nga pasojat

1 pikë Nëse shkruan një nga pasojat

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

Pyetja 20**Model përgjigjeje**

- rritje zero e popullsisë, me lindje shumë të pakta
- kemi të bëjmë me një popullsi të plakur
- moshë mesatare të lartë.
- Rritja është drejt zeros dhe në periudha të caktuara ka qenë negative.

3 pikë nëse nxjerr tre përfundime

OSE

2 pikë Nëse nxjerr dy përfundime

1 pikë Nëse nxjerr një përfundim

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare
